




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.Nr.151/2021

Datë: 26 maj 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Qemail Suka, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, duke vendosur sipas Raportit të Panelit Hetimor Nr.AD/KGJK/04/2021/GJTHPZ-AD/GJTHP.nr.1/2021, të datës 07 maj 2021, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores (05/2019) për Procedurën Disiplinore të Gjyqtareve, në seancën dëgjimore, të mbajtur me 26 maj 2021, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Qemail Suka**, Gjyqtar në Gjykatën e Themelore në Prizren, **është** përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve.
- II. Gjyqtarit **Qemail Suka** i shqiptohet sanksion disiplinor **Vërejtje publike me shkrim**.

A r s y e t i m

Paneli Hetimor i themeluar me vendim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.nr.71/2021, të datës 24 mars 2021, për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/04/2021/GJTHPZ-ADGJTHP.nr.1/2021, të datës 7 maj 2021, i ka paraqitur Këshillit Gjyqësor të Kosovës raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkelje disiplinore të pretenduar të Qemail Suka, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren.

KGJK me datë 26 maj 2021, për ta shqyrtuar këtë çështje ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore ku morën pjesë Kryesuesja e Panelit Hetimor Snezhana Mihajlovic dhe subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Qemail Suka.

Kryesuesja e Panelit Hetimor në fillim të seancës dëgjimore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ndaj gjyqtarit Suka është bërë hetim disiplinor me kërkesën e autoritetit kompetent e i cili kishte vepruar sipas kërkesës së palës së dëmtuar , i cili është ankuar se gjyqtari Suka ka prolonguar pa arsye shqyrtimin e çështjes penale me shenjen P.nr.653/16 ku i njëjti ka qenë palë e dëmtuar.

Ka shtuar se nga provat e administruara është vërtetuar se gjyqtari Suka ka kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 3, pika 2.2, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve, sepse nuk i ka trajtuar palët në pajtim me ligjin dhe nuk ka marrë masa të

mjaftueshme, të vlefshme dhe në kohë, qe i pandehuri të sillet para drejtësisë, ndërsa i dëmtuari të deklarohet për kërkesën e tij juridiko-pronësore.

Subjekti i hetimit disiplinor në seancën dëgjimore të KGJK-së, ka deklaruar se lëndën penale P.nr.653/2016, e ka pranuar me datë 7.09.2016, ndërsa seancën e parë e ka caktuar me datë 12.7.2018. Për këtë seancë gjyqësore i akuzuari kishte pranuar ftesën por nuk kishte arsyetuar mos prezencën e tij dhe me datë 7.11.2018 ka kërkuar shtyrjen e seancës për 2 deri 3 muaj, për arsye shëndetësore. Me tutje gjyqtari Suka ka deklaruar se ka ndërmarr të gjitha veprimet, nuk i ka pranuar si të besueshme provat e të akuzuarit për shtyrje të seancës dhe me datë 14.11.2018, ka lëshuar urdhër arrestin. Pasi nuk kishte pranuar njoftim nga policia lidhur me urdhër arrestin e lëshuar, gjyqtari Suka me datë 03.03.2020, ka përsëritur edhe një herë urdhër arresti dhe si pasojë e kësaj rrjedhe të situatës, me datë 31.01.2021 ka ardhur deri tek parashkrimi absolut i lëndës konkrete. Sipas deklaratës se gjyqtarit Suka nuk ka pasur ndonjë qëllim të caktuar, dhe në këtë vonesë përveç problemeve të lartcekura ka ndikuar edhe ngarkesa shume e madhe me lëndë.

Për të vërtetuar këtë çështje KGJK administroi këto prova: akuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.642/15, të datës 01.09.2016; flet kthesa; kërkesa për shtyrje të seancës e paraqitur nga i pandehuri më 14.09.2018; raporti specialistik i datës 3.09.2018, në emër të personit të akuzuar; procesverbali i seancës së parë i datës 14.11.2018; kërkesa për shtyrje të seancës; urdhër arresti i datës 14.11.2018; flet kthesa e policisë së Kosovës; aktvendimi P.nr.653/2016, të datës 01.02.2021; ankesa e personit të dëmtuar _____ e datës 01.12.2021, me të cilën i është drejtuar kryetarit të gjykatës për inicim të procedurës disiplinore; raportin e panelit hetimor mbi faktet dhe provat e mbledhura dhe të gjithë provat e tjera të bashkangjitura kësaj lëndë disiplinore; si dhe dëshminë urdhër arrestin P.n.653/16, të lëshuar ndaj _____ i cili është lëshuar me datë 03.03.2020, të cilat prova gjyqtari Suka e ka sjell tek KGJK-ja, si dhe ka dëgjuar kryesuesin e Panelit Hetimor dhe gjyqtarin Qemail Suka.

Pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe të gjitha së bashku, KGJK vërtetoi këtë gjendje faktike: gjyqtari Suka lëndën penale P.nr.653/16, e kishte pranuar me datë 07.09.2016, ndërsa seancën e kishte caktuar pas dy vitesh dhe atë me datë 12.07.2018. Në këtë seancë i pandehuri edhe pse i ftuar me rregull nuk ishte përgjigjur dhe nuk kishte arsyetuar mos prezencën. Me datë 07.11.2018, i pandehuri kishte kërkuar shtyrjen e seancës për 2 deri 3 muaj me arsyetim se është i sëmur. Provat për këtë kërkesë për shtyrje të seancës gjyqësore gjyqtari Suka nuk ja kishte falur besimin dhe me procesverbalin e seancës së datës 14.11.2018, ka lëshuar urdhër arrestin. Me datë 03.03.2020, kishte përsëritur urdhër arrestin e njëjtë në cilin urdhër arrest figuroj tre data, në pjesën hyrës është data e smilit lartë ku është shënuar 15.11.2018, tek pjesa hyrës data 03.03.2020, dhe në fund data 14.11.2018, dhe pasi qe policia nuk e kishte informuar lidhur me këtë urdhër arrest, me datë 31.01.2021, kishte ardhur deri të parashkrimi absolut. Pas administrimit dhe analizimit të provave qe kanë ekzistuar në shkresat e lëndës, KGJK-ja ka gjetur vetëm një urdhër arrest të lëshuar nga Gjyqtari Suka, dhe ky urdhër arrest është me tre data të ndryshme, siç është cekur edhe me lartë.


Këshilli Gjyqësor i Kosovës në seancën për këshillim dhe votim në mënyrë unanime konstatoi dhe vendosi se Gjyqtari Suka është përgjegjës për shkelje disiplinore nga pakujdesia e rendë, të përcaktuar në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

KGJK, me kujdes analizoi se cila nga sanksionet disiplinore i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij disiplinore, dhe vlerësoi se sanksioni disiplinor **vërejtje publike me shkrim**, është sanksioni më i përshtatshëm me të cilin do të arrihet përmirësimi i sjelljes së gjyqtarit dhe do të shërbejë si preventiv për të ardhmen e tij.

Nga sa u tha me lartë e konform nenit 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit nr.06/l-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.Nr.151/2021, datë: 26 maj 2021

Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Artan Sejrani, U.D. i Kryetarit në Gjykatën Themelore në Prizren;*
- *Qemail Suka, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren;*
- *Arkivit.*